

**Vendim nr. 55 datë 13.03.2023**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Marjana Semini, Anëtare

Sandër Beci, Anëtar

në datën 13.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 33 (B) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **BARDHYL IBRA**

**OBJEKTI:** **Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm të kërkesës nr. 7/2021 të regjistrimit themeltar, datë 29.12.2021, në sekretarinë e Gjykatës së Lartë.**

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Bardhyl Ibra, në datën 13.01.2016, ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt: *“Detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë të ushtrorë kontroll sipas ligjit në organin e prokurorisë dhe raportimin te Presidenti i Shqipërisë.”*.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 650 (80-2016-637), datë 17.02.2016, ka vendosur kthimin e padisë së bashku me aktet bashkëlidhur, me arsyetimin se kërkuesi, pavarësisht se kishte marrë dijëni rregullisht, nuk kishte plotësuar të metat e padisë lidhur me paraqitjen e provave dhe pagesën e taksës gjyqësore të kërkesëpadisë.

3. Kundër këtij vendimi, në datën 12.04.2016, ka bërë ankim kërkuesi, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31025-035811-86-2017 akti, datë 30.06.2017.

4. Në mungesë të një vendimmarrjeje për çështjen nga Gjykata Administrative e Apelit, brenda afateve të parashikuara nga neni 48, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji 49/2012)* dhe neni 399/2 i Kodit të Procedurës Civile (KPC), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë në datën 11.12.2019 me kërkesë me objekt: *“Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyimit brenda një afati të arsyeshëm të parashikuar nga germa “a” e nenit 399/2 të KPC, neni 48/2 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të çështjes administrative të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31025-035811-86-2017, datë 30.06.2017 dhe detyrimin e kësaj gjykate për përshpejtimin e gjyimit të çështjes. Marrja e informacionit të nevojshëm për këtë çështje nga ana juaj kësaj gjykate në bazë të nenit 399/4, paragrafi i parë, të KPC.” (kërkesa e parë).* Kjo kërkesë është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 15/21/13 të regjistrimit themeltar.

5. Ndërsa çështja ishte në pritje të shqyrtohej në Gjykatën e Lartë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë me objekt: *“Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë.”*. Me vendimin nr. 26, datë 12.02.2021 të Kolegjit të Gjykatës është vendosur moskalimi i çështjes në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk i kishte shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës së tij, pasi procesi në Gjykatën e Lartë ishte ende në shqyrtim.

6. Në lidhje me kërkesën e parë drejtuar Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 15/21/13, datë 22.12.2021, Kolegji Administrativ i kësaj gjykate, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 399, pika 8, të KPC-së, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se

vonesa në gjykimin e çështjes së tij ka ardhur për rrethana të pamundësisë objektive për procedim. Ky vendim pranohet nga kërkuesi se i është komunikuar në datën 02.02.2022 nëpërmjet shërbimit postar.

7. Më herët, në datën 29.12.2021, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për shkak të mosshqyrtimit të çështjes nga ajo gjykatë brenda afatit 45-ditor (*kërkesa e dytë*). Kjo kërkesë është regjistruar me nr. 7/2021 të regjistrimit themeltar.

8. Në datën 13.05.2022 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor të çështjes administrative nr. 31025-035811-86-2017 akti, datë regjistrimi 30.06.2017 në Gjykatën Administrative të Apelit dhe të çështjes nr. 15/21/13 të regjistrimit themeltar, datë 11.12.2019 në Gjykatën e Lartë.

9. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 78, datë 06.07.2022, ka vendosur: “*Kthimin e kërkesës për plotësim brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.*”, duke arsyetuar se kërkuesi duhet të saktësonte të drejtën ose interesin kushtetues ose të ligjshëm që qëndronte në thelb të procesit gjyqësor, për të cilin ai pretendonte se ishte në tejkalim të afatit të arsyeshëm.

10. Ndërkohë, për kërkesën e dytë të kërkuesit të paraqitur në Gjykatën e Lartë, me vendimin nr. 7, datë 19.07.2022, një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë (Kolegji Penal), bazuar në pikën 3 të nenit 399/7 të KPC-së, ka vendosur pushimin e gjykimit, me arsyetimin se kërkesa e parë është marrë në shqyrtim dhe është gjykuar në themel me vendimin e datës 22.12.2021, për rrjedhojë çështja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë dhe përshpejtimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së parë ka mbetur pa objekt. Po kështu, Kolegji Penal ka vlerësuar se dispozitat e KPC-së nuk garantojnë të drejtën e palës në një proces gjyqësor për të kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm për organin që shqyrton kërkesën për shkeljen e afatit të arsyeshëm për çështjen e themelit. Për rrjedhojë, kërkimi për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Kolegji Administrativ për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit, është i papranueshëm, pasi nuk ka lëndë dhe objekt gjykimi. Vendimi i Gjykatës së Lartë në këtë rast pranohet nga kërkuesi se i është komunikuar në datën 03.08.2022 nëpërmjet shërbimit postar.

11. Në datën 16.08.2022 kërkuesi, në mbështetje të vendimit nr. 78, datë 06.07.2022 të Kolegjit të Gjykatës, ka paraqitur aktin “Për plotësim të metash”, me të cilin ka kërkuar shqyrtimin e çështjes dhe pranimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë në çështjen nr. 15/21/13, datë 11.12.2019 dhe nga Gjykata Administrative e Apelit në

gjykimin e çështjes administrative nr. 31025-035811-86-2017 akti, datë regjistrimi 30.06.2017, si dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e saj. Në lidhje me këtë, me vendimin nr. 130, datë 12.10.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke vlerësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk ka arritur të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave të tij, në drejtim të dëmit/pasojave të drejtpërdrejta dhe reale të ardhura nga aktet e kundërshtuara në Gjykatën.

12. Me kërkesën e datës 22.12.2022, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga Gjykata e Lartë, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga nenet 399/6, shkronja “c” dhe 399/7, pika 2, të KPC-së, të kërkesës nr. 7/2021 të regjistrit themeltar.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

13. **Kërkuesi** pretendon se vendimi nr. 15/21/13, datë 22.12.2021 i Gjykatës së Lartë i është komunikuar në datën 02.02.2022, pra jashtë afatit ligjor. Në pritje të shqyrtimit të kërkesës së parë, ai ka paraqitur një kërkesë tjetër në Gjykatën e Lartë, atë nr. 7/2021 të regjistrit themeltar, datë 29.12.2021, shqyrtimi i së cilës është bërë tej afateve ligjore të parashikuara nga nenet 399/6 dhe 399 të KPC-së. Kërkesa e dytë është shqyrtuar në datën 19.07.2022 dhe i është komunikuar kërkuetit në datën 03.08.2022. Duke llogaritur kohëzgjatjen nga data e regjistrimit deri kur është bërë gjykimi, shqyrtimi i saj ka zgjatur 6 muaj e 22 ditë, ndërsa referuar datës së komunikimit të vendimit, ka zgjatur 7 muaj e 6 ditë, ndërkohë që afati i shqyrtimit sipas ligjit është 45 ditë. Për rrjedhojë, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i sigurisë juridike, si dhe e drejta për proces të rregullt, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm të kërkesës nr. 7/2021 të regjistrit themeltar, datë 29.12.2021, nga Gjykata e Lartë.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimitimin e kërkuetit

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ,

person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

15. Neni 134, pika 2, i Kushtetutës përcakton, ndër të tjera, se subjektet e përcaktuara në shkronjën “i” të pikës 1 të saj mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat tyre. Në këtë kuptim, individët duhet të provojnë përpara Gjykatës se shkeljet e pretenduara janë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të kundërshtuar dhe se janë viktima të shkeljes të së drejtës kushtetuese.

16. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me dy kërkesa për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt, si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Kërkesa e parë kishte të bënte me kohëzgjatjen e procesit në Gjykatën Administrative të Apelit për shqyrtimin e ankimit të tij, kurse kërkesa e dytë me kohëzgjatjen e shqyrtimit nga Gjykata e Lartë të asaj kërkesë.

17. Në lidhje me kërkesën e parë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 15/21/13, datë 22.12.2021, ka vendosur rrëzimin e saj, me arsyetimin se mosveprimi i gjykatës së apelit ka ndodhur për shkaqe të natyrës objektive. Kërkuesi është njoftuar rregullisht për këtë vendim në datën 02.02.2022. Më pas, ai ka paraqitur ankim kushtetues individual, për të cilin, pas kthimit të tij për plotësim, me vendimin nr. 130, datë 12.10.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione personae*, pasi nuk ka arritur të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave të tij, në drejtim të dëmit/pasojave të drejtpërdrejta dhe reale të ardhura nga aktet e kundërshtuara në Gjykatën (*shih paragrafët 8 dhe 9 të vendimit të Kolegjit*).

18. Në lidhje me kërkesën e dytë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 7, datë 19.07.2022, ka vendosur pushimin e gjykimit, mbështetur në pikën 3 të nenit 399/7 të KPC-së, pasi kërkesa për të cilën ajo gjykatë ishte vënë në lëvizje, që lidhej me procesin në gjykatën e apelit, tashmë ishte shqyrtuar dhe gjykuar me vendimin e datës 22.12.2021.

19. Pas njohjes me këtë vendim, kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës me kërkesën në shqyrtim, duke ngritur pretendime jo më për kohëzgjatjen tërësore të procesit gjyqësor të iniciuar prej tij, që ndodhej në pritje të gjykimit të ankimit në gjykatën e apelit, por duke pretenduar se shqyrtimi i kërkesës së dytë në Gjykatën e Lartë është bërë tej afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së.

20. Ligji procedural civil ka parashikuar mjetet për t'i garantuar individit mbrojtjen efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ose edhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm (*shih*

*vendimin nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i mjeteve të përcaktuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së është parandalimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes dhe shpërblimi i drejtë për shkak të kësaj kohëzgjatjeje. Dispozitat e KPC-së kanë përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*), etj. Sipas nenit 399/3 të KPC-së, shpërblim i drejtë konsiderohet njohja e shkeljes, masat e marra për përshpejtimin e procedurave dhe/ose shpërblimi i dëmit, i përcaktuar në vlerë monetare në nenin 399/10 të këtij kodi.

21. Këto mjete juridike synojnë të mbrojnë të drejtën e individit për proces të rregullt, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave të hetimit, të gjykimit të çështjeve (civile, penale ose administrative) dhe të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë, si dhe shpërblimin e drejtë për këtë shkak. Në këtë kuptim, këto mjete janë instrumente në dispozicion të individit dhe, si të tilla, nuk përbëjnë proces autonom nga ai i gjykimit të themelit të çështjes, i cili të gëzojë, për këtë shkak, edhe mbrojtje autonome të garancive të nenit 42 të Kushtetutës. Nëse do të pranohej e kundërta, atëherë do të humbiste kuptimi i natyrës përfundimtare të gjykimit kushtetues të ankesave individuale. Parë në këtë këndvështrim, ankimi kushtetues synon të mbrojë të drejtën për proces të rregullt pikërisht gjatë procedurave si më sipër, ndërkohë që procedurat e shqyrtimit të kërkesave për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin të procedurave, sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së mund të vlerësohen nga Gjykata vetëm në drejtim të efektivitetit të këtyre mjeteve procedurale. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës me kërkesën në shqyrtim.

22. Kolegji vëren, gjithashtu, se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur me ankime për të njëjtin proces gjyqësor, duke paraqitur si shkaqe kërkesa të së njëjtës natyrë, që në shumicën e rasteve bazoheshin në vendime jopërfundimtare. Edhe pse me vendime të kolegjeve të kësaj Gjykate i është kërkuar të paraqesë ankim kushtetues kur çështja e tij të jetë përfundimtare ose që të justifikojë interesin për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, duke u konstatuar më pas edhe mungesa e interesit të tij, kërkuesi ka vijuar të paraqesë kërkesa të së njëjtës natyrë dhe për të njëjtat shkaqe, duke shkuar në kufijtë e abuzimit jo vetëm me mjetet ligjore, por edhe me ankimin kushtetues individual.

23. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje të kërkuetit përmbajtjen e nenit 31/c të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit kur Gjykata konstaton se kërkuesi paraqet kërkesë abuzive

ose të përsëritur, për të njëjtin shkak dhe objekt, megjithëse ajo është shqyrtuar një herë nga Gjykata, urdhëron gjobitjen e tij dhe në një rast të tillë vendimi përbën titull ekzekutiv. Kjo dispozitë ka për qëllim të shmangë abuzimin me aksesin kushtetues, si dhe shpërdorimin e të drejtave kushtetuese të individëve. Megjithatë, në rastin konkret, në kushtet kur kërkuesi nuk është paralajmëruar më parë me vendim të kolegjeve për mundësinë e gjobitjes së tij për shkak të përsëritjes së kërkesave, Kolegji çmon se nuk është e arsyeshme të zbatohet neni 31/c i ligjit nr. 8577/2000.

24. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriteret paraprake, për rrjedhojë nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b” dhe “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.